



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK
Dep.	03/04/1852/16
Dep.	Prof. Dr. Prof. No. 06
Nr. fajd.	Date 14.05.2016
Broj stranica	06
Nr. pages	Date
PRISHTINA	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.05.2016 mori:

**V E N D I M**

- I. Ekziston konflikt interesit dhe papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik në rastin me nr. AKK -03-3959/15, për zyrtarin e lartë Goran Maksimovic – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Novobërdës dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “AGRO - MAX”.
- II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.
- III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

- I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051 (në tekstin e mëtejmë Ligji PKI), neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit, është inicuar rasti për zyrtarin e lartë Goran Maksimovic – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Novobërdës dhe njëkohësisht është pronar në biznesin privat “AGRO - MAX”.

Në fillim zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkresë, z. Maksimovic është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së. Ai është njoftuar me faktet që

posedon Agjencia për këtë rast, në lidhje me situatën e konfliktit të interesit respektivisht kufizimet që parashihen në Ligjin PKI për atë si zyrtar i lartë.

z. Maksimovic është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, nuk mund të ushtroj funksionin e pronarit dhe menaxherit në biznesin privat “AGRO - MAX” sepse është e ndaluar me nenin 15 dhe 16 të Ligjit PKI.

Pika 1 e nenit 15 shprehimisht përcakton se “*Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private*”.

Ndërsa pika 3 e nenit 16 përcakton se “*zyrtari i lartë publik nuk mund te ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë se saj*”.

Ndërkojë, Agjencia kundër Korruptionit nuk ka marrë informatë për shmangjen e kësaj gjendje, konform ligjit dhe rekomandimeve që i ishin bërë.

Me pas Agjencia kundër Korruptionit, konform nenit 18, paragrafi 5 të Ligjit PKI, zyrtarit të lartë, z. Maksimovic, i ka bërë edhe shkresën e dytë që quhet “Paralajmërim”, në të cilën e njofton ate për situatën në të cilën ndodhet, për masat tjera që mund të pasojnë, nëse gjendja nuk ndryshon dhe njëkohësisht i jep afat të ri, por të kufizuar ligjor, për ta ndryshuar këtë gjendje duke shmangur konfliktin e interesit.

Zyrtari i lartë Goran Maksimovic, nuk e ka përfillur këtë afat dhe deri më sot nuk e ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të Ligjit PKI (neni 14, pika 1 dhe 2) Personi, Zyrtari i lartë, pronari i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t'i transferojetë të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimit të ndërmarrjes tek ndonjë person të besuar. Zyrtari i lartë është i obliguar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga zgjedhja, vendosja ose emërimi në detyrë me post zyrtar, të bëjë transferimin e të drejtave në udhëheqjen e ndërmarrjes në personin e besuar kurse brenda afatit prej pesë (5) ditë nga data e transferimit se këtyre të drejtave ta njoftoj me shkrim Agjencinë.

**II.** Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin publik që të filloj procedurën për shkarkimin e tij. Kjo bazuar në nenin 18 (pika 8) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit i cili thotë: “*Në rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij*”.

**III.** Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nen 20, pika 1, “*Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3*”.

Sipas Nenit 20 pika 2, “*Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund t'i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit*”.

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni





**Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

---

U skladu sa članom 11(stav 11), članom 5(stav 1 tačka 1.5) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije , članom 18(stav 4, 8 i 12) Zakona br. 04/L-051 za sprečavanje sukoba interesa u vršenju javne funkcije, kao i članom 19(stav 11) Pravilnika br.01/2014 o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije je dana 19.05.2016 doneo sledeću :

**O D L U K U**

**I.Postoji sukob interesa i nespojivosti u vršenju javne funkcije u slučaju br. AKK -03-3959/15 za visokog zvaničnika Gorana Maksimovića- Direktora za Urbanizam, Katastar i Geodeziju u Opštini Novog Brda i istovremeno vlasnika u privatnom preduzeću "AGRO - MAX".**

**II. Agencija će tražiti od institucije gde zvaničnik vrši funkciju da započne postupak za njegovo razrešenje .**

**III. Agencija će zahtevati pokretanje Prekršajnog Postupka od strane nadležnog Suda .**

**IV. Sve odluke koje je izdala Agencija u vezi sa sukobom interesa se objavljuju na zvaničnom sajtu Agencije .**

**V Ova odluka stupa na snagu nakon potpisivanja**

**Obrazloženje**

**I. U skladu sa Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u obavljanju javne funkcije 04 / L-051 (u daljem tekstu: Zakon SSI), član 18 (stav 1 i 3), pod sumnjom o sukobu interesa, je pokrenut slučaj za visokog zvaničnika Gorana Maksimovića - Direktor za Urbanizam, Katastar i Geodeziju u opštini Novo Brdo i istovremeno je vlasnik privatnog preduzeća "Agro - MAX".**

Kao prvi postupak , visoki zvaničnik je službenim pismom od Agencije protiv Korupcije obavešten za početak razmatranja mogućeg stanja sukoba interesa. Nakon prijema tog pisma, g.

Maksimović je kontaktiran od strane službenika APK. On je upoznat sa činjenicama koje poseduje Agencija za ovaj slučaj, u vezi sukoba interesa odnosno ograničenja koje su predviđene za visoke zvaničnike u Zakonu SSI.

g.Maksimović je obavešten da tokom obavljanja javne funkcije kao visoki zvaničnik , ne može obavljati i funkciju vlasnika i menadžera u privatnom biznisu "AGRO - MAX", a prema članu 15 i 16 Zakona SSI.

Tačka 1 u članu 15. izričito predviđa da " Visoki zvaničnik ne može biti član upravnog ili kontrolnog organa privatnih preduzeća " .

Dok stav 3 člana 16 propisuje da "*visoki zvaničnik ne može da aktivno ostvaruje pravo svojine ili deo vlasništva u preduzeću, bez obzira na vrste aktivnosti.*"

U međuvremenu , Agencija protiv Korupcije nije dobio informaciju o izbegavanju ovakve situacije , u skladu sa zakonom i obavljenim preporukama..

Zatim je Agencija protiv Korupcije , u skladu sa članom 18. stav 5. SSI , visokom zvaničniku , gospodinu Maksimoviću , poslao i drugo službeno pismo pod nazivom " Upozorenje " , u kojem ga informiše o situaciji u kojoj se nalazi , za druge mere koje mogu da slede ako se situacija ne promeni i istovremeno daje novi rok , ali zakonski ograničen, da bi promenio ovu situaciju izbegavajući sukob interesa .

Visoki zvaničnik Goran Maksimović je ignorisao ovaj rok i do danas nije izbeagao sukob interesa u vršenju javne funkcije.

Prema Zakonu o Sukobu Interesa (član 14. stav 1. i 2 ) Lica , visoki zvaničnici , vlasnici akcija , odnosno deo kapitala u preduzeću , u toku vršenja javne funkcije , moraju da prenesu pravo na administraciju ili upravljanje preduzećem na neko poverljivo lice . Visoki zvaničnik je dužan da u roku od trideset (30) dana od izbora , preuzimanja , odnosno imenovanja na javnu funkciju , da prenese prava upravljanja preduzećem na pouzdanu osobu i da u roku od pet ( 5 ) dana od dana prenosa tih funkcija, u pisanoj formi obavesti Agenciju .

**II.** Agencija će tražiti od instituciju u kojoj viši zvaničnik obavlja javnu funkciju da započne pokretanje postupka za njegovo razrešenje . Ovo je zasnovana na članu 18 ( stav 8 ) Zakona o sprečavanju sukoba interesa , koji glasi : "*Ako lice,visoki zvaničnik nastavlja da obavlja poslove ili funkcije nespojive po ovom zakonu , uprkos upozorenju Agencije , tada Agencija zahteva od institucije u kojoj visoki zvaničnik vrši javnu funkciju da pokrene postupak za njegovo razrešenje.*"

**III.** Prema Zakonu o Sprečavanju Sukoba Interesa , člana 20. stav 1 , " *Svako kršenje obaveza utvrđenih ovim zakonom , kada ne postoji krivično delo, predstavlja prekršaj i kažnjava se novčanom kaznom prema ograničenjima određenim u stavovima 1.1 , 1.2 i 1.3*".

Prema Članu 20, stav 2, "*Zbog kršenja obaveza utvrđenih ovim zakonom, javnim službenicima, rukovodiocu ili šefovima vodećih institucija, pored kazne, sud može izreći i zaštitnu meru; zabrana vršenja javne funkcije u periodu od tri (3) meseca do jedne (1) godine.*"

IV. Prema članu 18 , stav 12, sve odluke izdate od strane Agencije u vezi sa sukobom interesa se objavljaju na zvaničnom sajtu Agencije .

Stoga je odlučeno kao u odredbi ove odluke.

Odluka se dostavlja:

- Visokom javnom zvaničniku
- Direktoru DSK;
- G./g-đi. (odgovornom službeniku).

Direktor Agencije protiv Korupcije

Hasan Preteni

